



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR QËLLIME TË VEÇANTA PËR
PROJEKTIN MBËSHTETJA PËR INTEGRIME EVROPIANE TË
KOSOVËS
PËR PERIUDHËN 1 JANAR 2021 DERI MË 31 MARS 2024

Prishtinë, qershor 2024

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

Shtojca II: Pasqyrat financiare të projektit

1 Opinioni i Auditimit

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore për Qëllime të Veçanta për projektin 'Mbështetja për Integritim Evropian të Kosovës' për periudhën 1 janar 2021 deri më 31 mars 2024, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për qëllime të veçanta për periudhën audituese është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me raportin financiar.

Për raportimin menaxherial, për kontrollet dhe zbatimin e rekomandimeve nuk kemi çështje për të ngritur.

1.1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të projektit Mbështetja për Integritim Evropian të Kosovës

Auditimi ynë i pasqyrave vjetore financiare për qëllime të veçanta merr parasysh pajtueshmërinë me kërkesat për raportim konform marrëveshjes si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në pasqyra financiare.

Opinion i pamodifikuar

Ne kemi audituar pasqyrat financiare për qëllime të veçanta të projektit të financuar nga MPJ e Norvegjisë për periudhën 1 janar 2021 deri më 31 mars 2024, i cili përfshinë një përmbledhje të burimit të fondeve dhe shpenzimeve të realizuara, pasqyrën e aplikimeve për tërheqjen e fondeve, dhe shpalosjet.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare për qëllime të veçanta në lidhje me projektin Mbështetja për Integritim Evropian të Kosovës për periudhën 1 janar 2021 deri më 31 mars 2024, paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kërkesat për raportim në marrëveshjen në mes të palëve, duke respektuar parimet kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i Çështjes - Baza për kontabilitet

- 1 Ne tërheqim vëmendjen tuaj, për faktin që:
 - Pasqyrat Financiare janë përgatitur në përputhje me kornizën për qëllime të veçanta dhe nuk mund të përdoren për një qëllim tjetër.
 - Realizimi i buxhetit të projektit ishte 74% apo 346,727€ nga 468,890€ sa ishin paraparë për periudhen tri vjeçare. Realizimi i ultë ishte ndikuar kryesisht nga pandemia dhe mosrealizimi i vizitave studimore dhe trajnimeve jashtë vendi për shkak të problemeve me organizimin dhe vizat.

Opinionin jonë nuk është modifikuar në lidhje me këtë çështje

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe organeve drejtuese/qeverisëse

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen e drejtë dhe të vërtetë e pasqyrave financiare për qëllime të veçanta, konform marrëveshjes së nënshkruar në mes Republikës së Kosovës përfaqësuar nga Ministri i Financave dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim. Këto informata përbëhen nga Pasqyra e Fondeve dhe Përdorimi i Tyre si dhe nga Pasqyra e tërheqjes së Fondeve.

U.D Sekretar i Përgjithshëm, Zyra e Kryeministrit të Kosovës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Zyrës së Kryeministrit.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit dhe Kornizën e Deklaratave Profesionale të INTOSAI (KDPI). Ky ligj dhe këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kritereve etike dhe ta planifikojmë dhe kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq deklarime materiale.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për marrjen e dëshmive të auditimit lidhur me shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshirë vlerësimin e rreziqeve të keq deklarimeve materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo të gabimit. Auditimi po ashtu përfshinë vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave të kontabilitetit të përdorura, si dhe të arsyeshmërisë së vlerësimeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të përgjithshëm të pasqyrave financiare.

Gjatë kryerjes së procedurës për vlerësimin e rrezikut, ne e marrim parasysh kontrollin e brendshëm përkatës në lidhje me përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, por jo me qëllim të shprehjes së opinionit lidhur me efektshmërinë e tij. Sidoqoftë, ne do t'ju komunikojmë me shkrim për ndonjë mangësi të konsiderueshme në kontrollin e brendshëm që është relevante me auditimin e pasqyrave financiare të cilat i identifikojmë gjatë auditimit.

2 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) në bazë të marrëveshjes nga MPJ e Norvegjisë dhe i zbatuar nga Zyra e Kryeministrit është përgjegjëse për kryerjen e auditimit financiar. Ky auditim përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave të tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare për qëllime të veçanta japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit 2021-2024;
- Nëse të gjitha fondet e jashtme janë përdorur në përputhje me kushtet e marrëveshjeve përkatëse të financimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në zbatim për fondet e ndara nga projekt i financuar nga MPJ e Norvegjisë dhe i zbatuar nga Zyra e Kryeministrit.
- Nëse pasqyrat financiare janë në pajtim me kërkesat e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës përfaqësuar nga Ministri i Financave dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim; dhe
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm.

Kemi analizuar veprimtarinë e Projektit “Mbështetje për Integrimin Evropian të Kosovës” i cili aktualisht operon në kuadër të Zyra e Kryeministrit i financuar nga MPJ e Norvegjisë, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale, si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që i kemi konsideruar të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit.

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Emine Fazliu, Ndihmëse e Auditorit të Përgjithshëm



Blerina Krasniqi, Drejtore e Auditimit



Aurora Morina, Udhëheqëse e ekipit



Ardiana Miftari, Anëtare e ekipit



Arlinda Mustafa, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse:** (1) pasi ka marrë dëshmi

auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimi të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government
Zyra e Kryeministrit
Ured Premijera – Office of the Prime Minister



Norwegian Embassy

“KOS-18/0005 Support to Kosovo’s European Integration” Project

Pasqyrat Financiare
Janar 2021-Mars 2024

HCDF

Human Capacity Development Facility

Përmbajtja

I. Historiku	3
II. Përmbledhja e Projektit	4
1. Deklarata e Projektit	6
2. Fondet ne dispozicion	6
3. Buxheti	6
4. Programimi	7
5. Implementimi	7
1. Pasqyra e pranimeve për Projektin KOS-18/0005 implementuar pranë Zyrës së Kryeministrit	7
2. Shpalosja e ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit.....	8
3. Raporti i ekzekutimi të buxhetit.....	8

I. Historiku

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) ndërmjet Bashkimit Evropian (BE) dhe Republikës së Kosovës, e cila ka hyrë në fuqi në prill të vitit 2016, është marrëveshja e parë gjithëpërfshirëse ndërmjet palëve që ka avancuar perspektivën evropiane të Kosovës në fazën e detyrueshme ligjore, marrëdhëniet kontraktuale. Kosova ka arritur kështu një moment themelor formal duke institucionalizuar marrëdhëniet e saj me BE-në duke filluar të përmbushë detyrimet drejt anëtarësimit të plotë. Për sa i përket fushëveprimit të saj, MSA-ja mbulon të gjitha fushat si marrëveshje të tjera të tilla të lidhura me shtetet potenciale kandidate dhe kandidate për anëtarësim në BE, përkatësisht katër shtyllat kryesore. E para është dialogu politik dhe bashkëpunimi rajonal dhe kriteret e anëtarësimit në lidhje me reformat institucionale (të mbuluara në fushën ndërsektoriale të reformës së administratës publike). E dyta përfshin fusha të lidhura drejtpërdrejt me tregun e brendshëm (të tilla si kapitujt e acquis mbi lëvizjen e lirë të mallrave, lëvizjen e lirë të shërbimeve, kapitalin dhe të drejtën për themelim, pastaj sigurinë ushqimore, prokurimin publik, tatimet dhe doganat, politikën e konkurrencës dhe mbrojtjen e konsumatorëve). Një e treta përfshin fusha të sundimit të ligjit, siç përkufizohen më gjerësisht, të tilla si punët e brendshme (drejtësia, liria dhe siguria), si dhe të drejtat themelore, sistemin e drejtësisë dhe politikat kundër korrupsionit. Shtylla e katërt, e mbuluar nga politikat e bashkëpunimit, përmban numrin më të madh të fushave të acquis: të tilla si bujqësia dhe zhvillimi rural, energjia, politika e transportit, statistikat, mjedisi, arsimi dhe kërkimi, etj.

Nisur nga implikimet e këtyre reformave, përmbushja e detyrimeve të MSA-së në mënyrë adekuate dhe në kohë kërkon një administratë publike efikase dhe efektive. Kjo, nga ana tjetër, kërkon forcimin e kapaciteteve të institucioneve shtetërore (Qeveria, parlamenti kombëtar, si dhe institucionet, agjencitë dhe rregullatorët e pavarur) të ngarkuara për përafrimin e legjislacionit kombëtar me acquis, zbatimin dhe përforcimin.

Për të arritur objektivat e përmendura më lart, dhe duke pasur parasysh rëndësinë e fushave të acquis për të cilat nuk ofrohet apo programohet asnjë mbështetje, propozohet që Qeveria e Mbretërisë së Norvegjisë dhe ajo e Republikës së Kosovës të bashkëpunojnë në kuadër të të këtij projekti mbi kapitujt e mëposhtëm të acquis:

- Kapitulli 4: Lëvizja e Lirë e Kapitalit;
- Kapitulli 9: Shërbimet Financiare;
- Kapitulli 10: Shoqëria e Informacionit dhe Media;
- Kapitulli 15: Energjia;
- Kapitulli 18: Statistikat;
- Kapitulli 19: Politika Sociale dhe Punësimi;
- Kapitulli 27: Mjedisi
- Kapitulli 28: Mbrojtja e konsumatorit dhe shëndetit; dhe
- Kapitulli 32: Kontrolli Financiar.

Më konkretisht, ngritja e kapaciteteve të mjaftueshme njerëzore të të gjitha institucioneve shtetërore, si ato koordinuese ashtu edhe zbatuese, është e nevojshme për zbatimin e MSA-së në nëntë (9) fushat e acquis të përshkruara më sipër. Fokusi do të vazhdojë të jetë në ndërtimin e kapaciteteve dhe ekspertizës mbi përmbajtjen e acquis dhe përafrimin e tij, si dhe për planifikimin e politikave në atë kuadër, dhe zbatimin dhe zbatimin. Kjo nevojë mbështetet edhe nga gjetjet e Raportit më të fundit të KE-së për Kosovën, i cili në përgjithësi ka vlerësuar se Kosova është ndërmjet një faze të hershme dhe një niveli të përgatitjes për përafrimin dhe zbatimin dhe zbatimin e acquis në nëntë (9) kapitujt e përshkruar më lart me kapacitete institucionale duke qenë ndër sfidat kryesore. Me fjalë të tjera, dobësitë e një administrate publike efektive të nevojshme për zbatimin e dispozitave të MSA-së janë kryesisht për shkak të kapaciteteve të pamjaftueshme, të nevojshme për t'u rritur, veçanërisht për përdorimin e të gjitha instrumenteve të nevojshme për hartimin dhe përafrimin e ligjeve dhe zhvillimin e politikave.

Duke u bazuar në bashkëpunimin e mëparshëm të suksesshëm ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Mbretërisë së Norvegjisë, diskutimet e përbashkëta në kuadër të mbështetjes norvegjeze për zbatimin e MSA-së kanë rezultuar në një parim që është zhvilluar për të hulumtuar rrugët e mundshme të mbështetjes së ndërtimit të kapaciteteve të administratës publike për zbatimin e MSA-së.

II. Përmbledhja e Projektit

Duke pasur parasysh gjendjen e përshkruar në Raportin e Progresit dhe letrën justifikuese, qëllimi i këtij projekti vazhdon të jetë mbështetja e administratës publike të Kosovës në zbatimin e MSA-së dhe rritjen e gatishmërisë për anëtarësim në BE në fushat e mëposhtme të acquis: kapitujt 4, 9, 10, 15, 18, 19, 27, 28 dhe 32.

Projekti do të punojë drejt një objekti/rezultati specifik:

- Rezultati: Përmirësimi i kapaciteteve njerëzore dhe ekspertizës së administratës publike për të zbatuar dhe përforcuar legjislacionin kombëtar të harmonizuar me acquis në të gjitha fushat e synuara.

Projekti do të ketë një rezultat:

- Rezultati: Ekspertiza për zbatimin e legjislacionit kombëtar të përafruar me acquis në nëntë fushat e ndërhyrjes është forcuar përmes trajnimeve të specializuara jashtë vendit dhe vizitave studimore.

Më poshtë janë institucionet përfituese të projektit për secilin kapitull të synuar të acquis:

- Kapitulli 4: Lëvizja e Lirë e Kapitalit: Zyra e Kryeministrit, Ministria e Financave e Punës dhe Transfereve, Dogana e Kosovës, Administrata Tatimore e Kosovës dhe Banka Qendrore e Kosovës;
- Kapitulli 9: Shërbimet Financiare: Zyra e Kryeministrit, Ministria e Financave e Punës dhe Transfereve, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe Banka Qendrore e Kosovës;

- Kapitulli 10: Shoqëria Informative dhe Media: Zyra e Kryeministrit, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Mjedisit, Planifikimi Hapësinor dhe Infrastrukturës, Komisioni i Pavarur për Media dhe Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare;
- Kapitulli 15: Energjia: Zyra e Kryeministrit, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Mjedisit, Planifikimi Hapësinor dhe Infrastruktura, Zyra e Rregullatorit për Energji dhe Agjencia e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore;
- Kapitulli 18: Statistikat: Zyra e Kryeministrit dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës;
- Kapitulli 19: Politika Sociale dhe Punësimi: Zyra e Kryeministrit, Ministria e Financave e Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Shëndetësisë;
- Kapitulli 27: Mjedisi: Zyra e Kryeministrit dhe Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
- Kapitulli 28: Mbrojtja e Konsumatorit dhe Shëndetësisë: Zyra e Kryeministrit, Ministria e Industrisë, Sipërmarrjes dhe Tregtisë dhe Ministria e Shëndetësisë; dhe
- Kapitulli: 32: Kontrolli Financiar: Zyra e Kryeministrit, Ministria e Financave e Punës dhe Transfereve dhe Zyra Kombëtare e Auditimit.

Projekti KOS-18/0005 “Mbështetje për Integrimin European të Kosovës”

Mbështetur nga Ministria e Jashtme e Qeverisë së Mbretërisë së Norvegjisë

Viti 2021-Viti 2024

1. Deklarata e Projektit

Pasqyrat financiare përgatiten në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme, ku të ardhurat njihen kur merren dhe jo kur fitohen, dhe shpenzimet njihen kur paguhen dhe jo kur ndodhin.

Entitet i sektorit publik Zyra e Kryeministrit ka përgatitur Pasqyrat Financiare në harmoni me kërkesat e Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063 dhe Ligjin nr. 05/L-007. Sipas LMFPP të gjitha transaksionet me fonde brenda Fondit të Konsoliduar të Republikës së Kosovës behën përmes Llogarisë së Vetme të Thesarit.

Të gjitha shumat janë në Euro (EUR) dhe kanë të bëjnë vetëm me aktivitetet operative. Kostot e blerjes së pajisjeve dhe furnizimeve të pashpenzueshme janë shpenzime me pagesë. Rrjedhimisht, asnjë tarifë zhvlerësimi nuk kërkohet të lihet mënjane.

2. Fondet në dispozicion

Fondet janë të depozituara në nën llogarinë SIMFK pranë Bankës Qëndrore të Kosovës dhe menaxhohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit sipas kërkesës së autoriteteve përgjegjëse dhe ekzekutuese.

57 - QEVERIA E NORVEGJISË

104 - ZYRA E KRYEMINISTRIT

39000 - DEPARTAMENTI PER INTEGRIME EVROPIANE

3. Buxheti

Projekti ka qenë i dakorduar për të përfituar fondin në shumën e 14,160,000 NOK (Norwegian Kroner) e konvertuar në 1,466,350 Euro sipas kembimit valutor.

Buxheti është i ndarë në dy linja buxhetore:

11- Paga dhe shtesa

13-Mallra dhe shërbime

Në çdo fillim viti, ky buxhet mbartet në vitin pasardhës sipas marrëveshjes së rregulluar me aktivitetet e planifikuara.

4. Programimi

Programimi është ndarja e buxhetit gjatë kohëzgjatjes së projektit dhe nuk mund të jetë më e lartë se buxheti financiar. Programimi është i strukturuar në detyra dhe aktivitete dhe në këtë mënyrë përfaqëson dhe buxhetin operacional.

Projekti filloi zyrtarisht më 12 nëntor 2018, megjithatë për shkak të ndryshimeve institucionale duke përfshirë krijimin e një njësie specifike të projektit në kuadër të Ministrisë së Integritimit Evropian, caktimin e një koordinatori të ri nga Ministria e Integritimit Evropian me Ambasadën e Norvegjisë për të marrë drejtimin e Norvegjisë. Në kapituj, Projekti nuk ka ecur në përputhje me Programimin gjatë vitit 2019. Me këtë u tha, shuma e disbursuar në fillim të projektit më 14 dhjetor 2018 është mbartur në vitin pasardhës e kështu me radhë. Fondet janë disbursuar nga donator dhe janë alokuar direkt në Departamentin e Thesarit në Ministrinë e Financave. Granti është disbursuar gjithnjë bazuar në nevojat financiare të projektit për aktivitetet e planifikuar dhe për shpenzimet e personelit të Projektit.

5. Implementimi

Projekti ka qenë i vendosur për tu implementuar pranë Ministrisë së Integritimit Evropian, por më pas ka gjetur implementim dhe zbatim pranë Zyrës së Kryeministrit në ndërtesën e Qeverisë.

Projekti ka pasur staf të angazhuar dy konsulente të cilët kanë performuar detyrat e dhëna për të ofruar mbështetje për procesin e Integritimit Evropian dhe zyrtarëve përgjegjës për kapitujt Acquis të BE-së. Konsulentët kanë qenë të angazhuar fillimisht për një periudhë prej 36 muajsh, por më pas me vazhdimësinë e projektit pa kosto shtesë, përfundojnë angazhimin e tyre në 30 prill 2024.

1. Pasqyra e pranimeve për Projektin KOS-18/0005 implementuar pranë Zyrës së Kryeministrit

	<u>2024</u>	<u>2023</u>	<u>2022</u>	<u>2021</u>
Shënim				
Burimet e fondeve				
Grante nga donatorët	1			266,830.57
Gjithsej				<u>266,830.57</u>

Shënim 1: Granti i pranuar nga donator është bërë në dy ndarje kohore të ndryshme:

Shuma fillestare e disbursuar nga donatori ka qenë në vlerën e 293,014.63 Euro në datën 14.12.2018. Duke qenë se ka pasur vonesë të implementimit të aktiviteteve gjatë periudhës 2019-2020, kjo ka qenë ende në buxhet të Thesarit nga viti 2018-2021 jo e shpenzuar plotësisht, andaj në planifikimet e reja të aktiviteteve siç do të shihet më poshtë ato do të jenë shumat e kërkuara për vazhdimësi.

Shuma 56,612.27 është pranuar pranë Fondit Burimor 57 në datën 21.06.2021.

Shuma 210,218.30 është pranuar pranë Fondit Burimor 57 në datën 10.12.2021.

Pra, totali i të hyrave si fond nga donatori për vitin 2021 është 266,830.57.

2. Shpalosja e ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit

Shënim	<u>2024</u>	<u>2023</u>	<u>2022</u>	<u>2021</u>
Të hyrat	180,689.17	284,173.54	375,357.70	468,889.71
Gjithsej pranime	<u>180,689.17</u>	<u>284,173.54</u>	<u>375,357.70</u>	<u>468,889.71</u>
Shpenzimet				
<i>Pagesa</i>	59,615.88	101,175.37	91,184.16	94,751.21
Gjithsej pagesa 2021-2024		<u>346,726.62</u>		

Shënim 2. Gjithsej hyrje për Projektin KOS-18/0005 nga viti 2018-2021 është shuma: 468,889.71. Më pas me largimin e Ambasadës Norvegjeze në Prishtinë, Kosovë dhe me riorganizimin e implementimit të projekteve që ishin duke operuar, fondet për disbursim siç ishte dakorduar në marrëveshje ndaluan se u disbursuari dhe aktivitetet vijuan me fondin e ngelur tashme në Thesar.

3. Raporti i ekzekutimi të buxhetit

Shënim	<u>2024</u>	<u>2023</u>	<u>2022</u>	<u>2021</u>
Të hyrat	180,689.17	284,173.54	375,357.70	468,889.71
Shpenzimet				
<i>11-Paga dhe shtes 3</i>			10,062.50	28,520.23
<i>13-Mallra sherbime</i>	59,615.88	101,175.40	81,121.66	66,230.98
Kthimet/ Balanci gjendjes	121,073.29	182,998.14	284,173.54	374,138.50

Shënim 3: Për shkak të alokimit më të mirë të fondeve të mbetura pranë Fondit Burimor 57, Projekti KOS-18/0005 u dakorduar me Projektin KSV/019 që konsulentët të cilët paguheshin nga kodi 57, të paguhen nga kodi 56 –KSV/019 i financuar nga Qeveria e Luksemburgut. Pagesat e fundit për konsulentët ka qenë në muajin prill 2022.

Ndryshimet në kthime dhe çelje të fillimit të vitit financiar të ri kanë ardhur si pasojë e korigjimeve të bëra për pagesa të realizuara gabimisht nga kodi 56 të cilat janë rregulluar me transferta.



z. Arben Krasniqi

U.D Sekretar i përgjithshëm
*Zyra e Kryeministrit/ Kancelarija
Premiera / Prime Minister Office*

Qeveria –Vlada – Government



z. Ilir Muçaj

Menaxheri Projektit KOS-18/00005